



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 janar 2013
Nr. ref.: RK341/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI83/12

Parashtruesit

Muhamet Ukalo
Neime Ukalo

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 521/2009, të 4 qershorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Z. Muhamet Ukalo dhe Znj. Neime Ukalo, me vendbanim në Prizren (në tekstin e mëtejme: "Parashtruesi i kërkesës").

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 521/2009, të 4 qershorit 2012, të cilin e kanë pranuar më 1 gusht 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktgjykimi i lartpërmendur i ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "Kushtetuta"), respektivisht neni 31 [E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 46 [Mbrojtja e pronës], dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: the "KEDNJ"), respektivisht neni 6 (E drejta në proces të rregullt) dhe neni 1 (Mbrojtja e pronës) e Protokollit 1 të KEDNJ.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese së Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: "Ligji") dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 17 shtator 2012, Parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së (në tekstin e mëtejshëm: "Gjykata").
6. Më 5 tetor 2012, Kryetari i gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR.KI-83/12, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović si gjyqtar raportues. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH.KI-83/12, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 5 nëntor 2012, Kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.
8. Më 27 nëntor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 21 shkurt 1963, babai i Parashtruesve të Kërkesës nënshkroi kontratën për shitjen e patundshmërisë me Ndërmarrjen Shoqërore "KBI Progress" (në tekstin e mëtejshëm: NSH "KBI Progress").
10. Më 15 prill 1967, prona e patundshme iu shit personit të tretë, A.Q.
11. Më 6 dhjetor 1968, babai i Parashtruesit të Kërkesës nënshkroi kontratën për dhuratë për një tjetër pronë të patundshme me NSH-në "KBI Progress".
12. Më 1 shkurt 2001, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 69/2000) e aprovoi padinë e Parashtruesve të Kërkesës dhe konfirmoi se kontratat e nënshkruara më 21 shkurt 1963 dhe më 6 dhjetor 1968 janë të pavlefshme. Pastaj, Gjykata Komunale e obligoi NSH-në "KBI Progress" t'i pranohet si pronarë të patundshmërisë dhe t'ua dorëzojë në përdorim të lirë dhe posedim si dhe t'ua lejojë regjistrimin e pronës së patundshme në shërbimin kadastral në emër të Parashtruesve të kërkesës. Gjykata

Komunale në Prizren konsideron se “Në pajtim me nenin 37 të Ligjit Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Fleta Zyrtare 6/1980, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, janar 30, 1980) pronari mundet të kërkojë me padi kthimin e pronës së paluajtshme me kusht që Parashtruesi mund të konfirmojë se ai/ajo ka të drejtë në pronësinë e pronës së kthyer të paluajtshme.” Për më tepër, Gjykata Komunale konsideron se kontratat e lidhura nga babai i Parashtruesve të kërkesës janë të pavlefshme, sepse ato janë lidhur nën presion dhe rrjedhimisht nuk kanë ndonjë efekt ligjor. Ky aktgjykim mori formën e prerë dhe detyruese më 26 mars 2001.

13. Më 4 prill 2001, Gjykata Komunale në Prizren (Vendimi C. nr. 69/2000) nxori Aktvendimin me të cilin e korrigjoi aktgjykimin e saj të 1 shkurtit 2001. Gjykata Komunale e Prizrenit gabimisht nuk e kishte përfshirë sipërfaqen e tërësishme të patundshmërisë që duhet ti kthehet Parashtruesve. Ky aktvendim mori formën e prerë dhe detyruese më 20 prill 2001.
14. Më 30 prill 2001, Parashtruesit e kërkesës ushtruan propozim në Gjykatën Komunale në Prizren për përmbarimin e Aktgjykimit të formës së prerë dhe detyrues së Gjykatës Komunale në Prizren.
15. Më 22 qershor 2001, the Gjykata Komunale në Prizren (E. nr. 22/01) e lejoi përmbarimin. Më 5 korrik 2002, A.Q. ushtroi kundërshtim dhe kërkoj nga Gjykata Komunale në Prizren që ta shpallë vendimin për përmbarim të 22 qershorit 2001 të papranueshëm.
16. Më 30 gusht 2002, Gjykata Komunale në Prizren (Vendimi E. nr. 22/01) e suspendoi procedurën e përmbarimit sepse A.Q. pretendon se A.Q. e ka të drejtën e pronësisë mbi patundshmërinë e kontestuar. Gjykata Komunale në Prizren e këshilloi më tej A.Q. për të filluar procedurën kontestimore për të zgjidhur kush është pronar i ligjshëm i pronës së patundshme dhe të konfirmojë se përmbarimi është i palejueshëm.
17. Më 1 tetor 2002, A.Q. paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prizren kundër Parashtruesve dhe NSH-së “KBI Progress” në mënyrë që vendimi për përmbarim të shpallet i palejueshëm dhe të konfirmohet e drejta pronësisë e A.Q.:
18. Më 17 dhjetor 2002, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 556/02) e miratoi padinë e A.Q. duke vërtetuar se A.Q. është pronare e pronës së kontestuar pronësore, bazuar në posedim, mbajtje dhe i obligon Parashtruesit e kërkesës t’ia njohin A.Q. të drejtën dhe të lejojnë regjistrimin e pronës së pamundshme kontestuese. Për më tepër, Gjykata Komunale në Prizren e shpall përmbarimin e vendimit të Gjykatës Komunale E. nr. 22/01 të 22 qershorit 2001 si të papranueshme. Gjykata Komunale në Prizren konsideron:
 - a. se A.Q. kurrë nuk ka marrë pjesë në procedurë kur Gjykata Komunale e nxori Aktgjykimin e saj (C. nr. 69/2000) më 1 shkurt 2001 dhe më së pari kuptoi për procedurën kur Gjykata Komunale në Prizren doli në pronën e patundshme të për ta përmbaruar vendimin e saj;
 - b. se A.Q. është mbajtëse në besim e pronës e patundshmërisë së kontestuar prej 1970 deri më tani A.Q. ka poseduar pronën e patundshme të kontestuar bazuar në një transaksion të vlefshëm ligjor– marrëveshja e shitblerjes së nënshkruar më 15 prill 1967. A.Q. ka përdorur pronën e patundshme të kontestuar pa u penguar nga askush ose në ndonjë mënyrë tjetër. Për më tepër, A.Q. nuk dinte asgjë për procedurën në lidhje pronën e kontestuar derisa Gjykata Komunale në Prizren, doli në pronën e kontestuar për ta përmbaruar vendimin E. nr. 22/01 të 22 qershorit 2001;

- c. se është e vërtetë se patundshmëria e kontestuar ishte e regjistruar si ndërmarrje shoqërore kur i është shitur NSH-së “KBI Progress” më 21 shkurt 1963, por pasi që kontratat u shpallën të pavlefshme nga Gjykata Komunale në Prizren më 1 shkurt 2001 (Aktgjykimi C. nr. 69/2000), atëherë patundshmëria e kontestuar kurrë nuk ka qenë pronë shoqërore;
- d. se A.Q. e ka fituar të drejtën në pronë, bazuar në posedim – në mbajtje, në pajtim me nenin 28 paragrafi 4 i Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (Fleta Zyrtare 6/1980, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, janar 30, 1980).

Parashtruesit e kërkesës u ankuan kundër këtij Aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

- 19. Më 28 janar 2004, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi Ac. nr. 254/2003) e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e Parashtruesve të kërkesës dhe e mbështeti Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren të 17 dhjetorit 2002. Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij Aktgjykimi.
- 20. Më 21 korrik 2004, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 137/2004) aprovoi kërkesën për revizion dhe anuloi aktgjykimin e gjykatave më të ulëta dhe ia ktheu lëndën gjykatës së instancës së parë për rigjykim. Gjykata Supreme konsideron se “Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në faktin se ekziston një kontradiktë në mes të asaj çka është thënë në arsyetim dhe provave të administruara në seancën për shqyrtimin kryesor.” Për më tepër, Gjykata Supreme gjithashtu konsideron se ajo “[...] nuk mund të pranojë përfundimin e gjykatës së shkallës së dytë, meqë me Ligjin për Ndryshimin e Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Flet. Zyr. e Jug. 29/96) është shlyer neni 29 i Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, i cili parashikonte se nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pasuri shoqërore me parashkrim fitues, pas këtij ndryshimi mbi pronën shoqërore mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, një normë ligjore bihet për të rregulluar raportet juridike në të ardhmen, përveç nëse në ligj shprehimisht është cekur se kjo normë ka ndikim prapaveprues. Me ligjin e përmendur më lart nuk është parashikuar se kjo normë ka ndikim prapaveprues.”
- 21. Më 2 qershor 2008, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 160/04) e miratoi padinë e A.Q. duke vërtetuar se A.Q. është pronare e pronës së kontestuar pronësore, bazuar në posedim, mbajtje dhe i obligon Parashtruesit e kërkesës t’ia njohin A.Q. të drejtën dhe të lejojnë regjistrimin e pronës së paluajtshme kontestuese. Për më tepër, Gjykata Komunale në Prizren e shpall përmbarimin e vendimit të Gjykatës Komunale E. nr. 22/01 të 22 qershorit 2001 si të papranueshme. Gjykata Komunale në Prizren konsideron:
 - e. se A.Q. kurrë nuk ka marrë pjesë në procedurë kur Gjykata Komunale e nxori Aktgjykimin e saj (C. nr. 69/2000) më 1 shkurt 2001 dhe më së pari kuptoi për procedurën kur Gjykata Komunale në Prizren doli në pronën e patundshme të për ta përmbaruar vendimin e saj;
 - f. se A.Q. është mbajtëse në besim e pronës e patundshmërisë së kontestuar prej 1970 deri më tani. A.Q. ka poseduar pronën e patundshme të kontestuar bazuar në një transaksion të vlefshëm ligjor – marrëveshja e shitblerjes së nënshkruar më 15 prill 1967 A.Q. ka përdorur pronën e patundshme të kontestuar pa u penguar nga askush ose në ndonjë mënyrë tjetër. Për më tepër, A.Q. nuk dinte asgjë për procedurën në lidhje me pronën

- e kontestuar derisa Gjykata Komunale në Prizren, doli në pronën e kontestuar për ta përmbaruar vendimin E. nr. 22/01 të 22 qershorit 2001;
- g. se është e vërtetë se patundshmëria e kontestuar ishte e regjistruar si ndërmarrje shoqërore kur i është shitur NSH-së “KBI Progress” më 21 shkurt 1963, por pasi që kontratat u shpallën të pavlefshme nga Gjykata Komunale në Prizren më 1 shkurt 2001 (Aktgjykimi C. nr. 69/2000), atëherë patundshmëria e kontestuar kurrë nuk ka qenë pronë shoqërore;
- h. se A.Q. e ka fituar të drejtën në pronë, bazuar në posedim – në mbajtje, në pajtim me nenin 28 paragrafi 4 i Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (Fleta Zyrtare 6/1980, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, janar 30, 1980).
- i. se *“duke u thirr në vërejtjet e dhëna në aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 137/04 të dt. 21.07.2005, gjykata konstatoi se në bazë të rregullave juridike të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur është themeluar kjo marrëdhënie juridike në mes të paditëses A. Q. me pronarin e mëparshëm Gj. Q. ka vlejte deri në hyrjen në fuqi të ligjit mbi bazat e marrëdhënieve juridiko pronësore, poseduesi në mirëbesim fiton të drejtën e pronësisë pas posedimit të pandërprerë në afat prej 20 viteve, edhe pse nuk ka qenë posedues i ligjshëm. Në rastin konkret paditësja gjithsesi është poseduese në mirëbesim nga se me lidhjen e kësaj kontrate të vlefshme juridike e ka konsideruar veten pronare dhe mbi këtë bazë ka qenë poseduese. Çfarëdo procedure që ashte zhvilluar më vonë paditësja nuk ka qenë e njoftuar e as që ka ditur për zhvillimin e ndonjë procedure lidhur me parcelën kontestuese e as lidhur me zhvillimin e procedurës, në këtë gjykatë.”*

Parashtruesit e kërkesës u ankuan kundër këtij Aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

22. Më 13 tetor 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi Ac. nr. 405/2008) hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e Parashtruesve të kërkesës dhe e mbështeti Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren të 2 qershorit 2008. Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij Aktgjykimi.
23. Më 4 qershor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 521/2009) hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për revizion dhe e mbështeti Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të 13 tetorit 2009.

Pretendimet e Parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe asaj Komunale u morën në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës dhe neni 6 (E drejta në Proces të Rregullt) neni 1 (Mbrojtja e Pronës) i Protokollit 1 i GJEDNJ, sepse Parashtruesit e kërkesës, gjoja, se *“[...] janë pronarë të pronës së patundshme të kontestuar sepse e kanë trashëguar atë. Kjo e drejtë, sipas Kushtetutës është e paprekshme dhe e garantuar. Sidoqoftë, me aktgjykimet e gjykatave të rregullta, e drejta e pronës i takon A.Q.”*
25. Për më tepër, Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se A.Q. *“[...] nuk është poseduese me mirëbesim e patundshmërisë së kontestuar, posaçërisht nga dita kur Gjykata Komunale në Prizren i ka anuluar kontratat [...]”, d.m.th. nga 1 shkurti 2001.*
26. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se Gjykata Komunale në Prizren më 2 qershor 2008 ishte e paanshme dhe si e tillë i ka shkelur të drejtat e garantuara me

Kushtetutë, neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], sepse Gjykata Komunale më 2 qershor 2008 nuk ka vepruar në pajtim me vërejtjet e bëra nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj të 21 korrikut 2004, Aktgjykimi Rev. no. 137/20.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata vëren se, në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë në lidhje ankesën e Parashtruesve të kërkesës, Gjykata duhet së pari të të shqyrtojë nëse Parashtruesit e kërkesës kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë që parashihen me Kushtetutë, siç janë specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
28. Rregulli 36 1 (c) i Rregullores së punës parasheh se *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar.”*
29. Gjykata Kushtetuese dëshiron të rikujton se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me lajthitjet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t’i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur t’i merr parasysht vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih: *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I)
28. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që Parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).
30. Në rastin e tanishëm, Parashtruesit e kërkesës thjesht kontestojnë nëse gjykatat e rregullta e kanë aplikuar në tërësi ligjin e aplikueshëm dhe nuk pajtohen me të gjeturat faktike të gjykatave të rregullta në lidhje me rastin e tyre.
31. Në të vërtetë, parashtruesit nuk i kanë mbështetur pretendimin në baza kushtetuese, duke treguar dhe nuk kanë ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë pse dhe si ishin procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih: *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
32. Prandaj, Parashtruesit e kërkesës nuk kanë treguar pse dhe si gjykatat e rregullta kanë vendosur “në mënyrë të njëanshme”, duke ua mohuar të drejtën e tyre në pronë.
33. Rrjedh se Kërkesa është e papranueshme sepse është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1.c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 27 nëntor 2012, njëzëri


VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Ivan Čukalović



Prof. dr. Enver Hasani